



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 271, datë 23.12.2024

PËR

**“CAKTIM TË PËRKOHSHËM TË DREJTUESIT TË PROKURORISË PRANË
GJYKATËS TË SHKALLËS SË PARË TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
ELBASAN”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, me pjesëmarrjen e:

1. Zonjës Mirela BOGDANI	Kryetar
2. Zotit Sokol STOJANI	Anëtar
3. Zotit Zeqir HODA	Anëtar
4. Zonjës Arta MANDRO	Anëtar
5. Zonjës Ledina RIZA	Anëtar
6. Zotit Moisi DUDA	Anëtar
7. Zotit Vatë STAKA	Anëtar
8. Zotit Olger EMINAJ	Anëtar
9. Zotit Erind GËRMENJI	Anëtar
10. Zotit Erind MERKURI	Anëtar
11. Zoti Erion FEJZULLA	Anëtar

në mbledhjen e datës 23.12.2024, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” e ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës shqyrtoi çështjen me objekt:

“Caktim të përkohshëm të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan”

BAZA LIGJORE:

1. Neni 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;



Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, si dhe ka lejuar këtë kandidat të vijojë me procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë.

5. Procedura e vlerësimit sipas kuadrit ligjor rregullator, për prokurorin zoti Kreshnik Ajazi, është në proces nga ana e Komisionit të Vlerësimit.
6. Duke qenë se, me vendimin nr. 207, datë 30.09.2024, të Këshillit zoti Kreshnik Ajazi është caktuar të ushtrojë funksionin e drejtuesit të zyrës së prokurorisë Elbasan për një periudhë deri në tre muaj, si dhe për shkak se, procedura administrative lidhur me vlerësimin i cili është ende në proces nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, propozoi caktimin për kohësisht të zoti Kreshnik Ajazi, në pozicionin e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, për një periudhë deri në tre muaj
7. Ky propozim vjen në zbatim të nenit 59 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, i cili parashikon se:

“1. Pozicioni i magjistratit mund të plotësohet për kohësisht, kur magjistrati me pozicion të përhershëm nuk është në gjendje të ushtrojë funksionin për një periudhë jo më shumë se tre muaj, për shkak të:

- a) caktimit në pozicione të tjera,*
- b) arsyeve të tjera të parashikuara nga ligji.*

Në referim të nenit 42/2, të ligjit të sipërpërmendur përcaktohet se:

“... Pozicioni është për kohësisht i lirë kur magjistrati që ka atë pozicion në mënyrë të përhershme, për të paktën 3 muaj, është për kohësisht në pamundësi për të ushtruar funksionin në atë pozicion.”

Referuar nenit 3 të Rregullores “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve”, miratuar me Vendimin Nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, përcaktohet se:

Neni 3

Kriteret për caktimin e përkohshëm të prokurorëve

- 1. Prokurori mund të caktohet për kohësisht në çdo pozicion të të njëjtit nivel ose të një niveli tjetër, për të cilin përmbush kërkesat dhe kriteret e parashikuara në ligj për këtë nivel apo pozicion, në të njëjtën prokurori ku ushtron funksionin ose në një prokurori tjetër.*
- 2. Këshilli i Lartë i Prokurorisë respekton për aq sa është e mundur vullnetin e prokurorëve gjatë caktimit të përkohshëm.*

Për sa më sipër, Këshilli i Lartë i Prokurorisë konstaton se:

8. Plotësimi i pozicionit vakant të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan është proces që garanton organizimin e punës, mirëfunksionimin e prokurorisë, përfaqësimin e prokurorisë në marrëdhënie me të tretët etj. Këshilli vlerëson se zoti Kreshnik Ajazi përmbush kriteret ligjore për të ushtruar këtë funksion si i caktuar për kohësisht



9. Ky caktim i përkohshëm me afat deri në tre muaj, mund të ndërpritet në çdo moment nëse Këshilli vendos të vijojë me procedurat e emërimit të drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 59 pika 1 dhe 4, të ligjit Nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa "a" të ligjit Nr.115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" i ndryshuar, Rregulloren "Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve" e ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Zoti Kreshnik Ajazi, aktualisht prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
2. Zoti Kreshnik Ajazi do të ushtrojë funksionin e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan për një periudhë deri në tre muaj.
3. Për periudhën e përmendur në pikën 2, zoti Kreshnik Ajazi do të paguhet me pagën e drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
4. Të njoftohen për këtë vendim zoti Kreshnik Ajazi, Prokurori i Përgjithshëm dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.

U shpall në Tiranë, sot më 23.12.2024.

KRYETAR
Mirela Bogdani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Erind Gërmenji

ANËTAR
Arta Mandro

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Ledina Riza

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erion Fejzulla